

## **MARRËVESHJE NDËRMJETËSIMI - QIRAMARRJE E HAPUR**

### **Për ndërmjetësim pasurie të paluajtëshme**

Në mbështetje të ligjit 29.07.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë “ neni 659 e vijues, sot më datë /2019 me vullnet të lirë, lidhet kjo marrëveshje ndërmjetësimi ndërmjet palëve si më poshtë  
Z i datëlindjes në madhor e me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar me letërnjoftimin (ID) Nr. dhe me nr kontakti +355 (në vijim të kësaj marrëveshje Klienti)  
dhe

Agjensi Ndërmjetësimi Pronash të Paluajtshme, regjistruar në Regjistrin Tregtar të Tiranës, me NIPT nr. me seli në adresën: .Rr. , përfaqësuar nga Z., madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me pasaportën/ kartë identiteti nr. , në vijim referuar si **AGJENSIA**

#### **Neni I**

#### **OBJEKTI I MARRËVESHJES**

1.1 Në bazë të kushteve të kësaj marrëveshje klienti angazhon agjensinë për shërbime ndërmjetësimi për marrjen me qira të një prone të paluajtshme sipas kërkesave të paraqitura nga klienti si më poshtë:  
Lloji i pronës Tipologjia Sipërfaqja e kërkuar Zona e kërkuar Buxheti i kërkuar

#### **Neni II**

#### **TË DREJTAT DHE DETYRIMET E AGJENSISË**

- 2.1 Agjensia do të kërkojë në tregun e pasurive të paluajtshme për të gjetur një pronë, që të plotësojë kërkesat e klientit për qiramarrjen nga ana e tij, si dhe të asistojë në realizimin e qiramarrjes së pronës për klientin.
- 2.2 Agjensia do të vendosë në dispozicion të klienti  
t të gjitha pronat që janë në sistem dhe përshtaten me kërkesën e klientit për qiramarrje.
- 2.3 Agjensia do të trajtojë të gjithë informacionin e marrë nga klienti në mënyrë konfidenciale në përputhje me ligjin “ Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” dhe nuk do të kryejë asnjë veprim i cili mund të çenojë interesat e klientit.
- 2.4 *Agjensia do të marrë pjesë në negociimin për nënshkrimin e kontratës së qirasë së pronës që do të merret nga klienti, duke i shërbyer interesave të këtij të fundit.*

#### **Neni III**

#### **TË DREJTAT DHE DETYRIMET E KLIENTIT**

- 3.1 Me nënshkrimin e kësaj marrëveshje, klienti do të informojë agjensinë rreth të gjitha kërkesave lidhur me kërkesën në fjalë.
- 3.2 Klienti duhet t’i vendosë në dispozicion agjensisë çdo informacion dhe dokument të nevojshëm për përmbushjen e detyrimeve të agjensisë sipas kësaj marrëveshje.
- 3.3 Klienti duhet të angazhojë agjensinë për dhënien e ofertave apo kërkimin e informacioneve specifike për pronën për të cilën interesohet.
- 3.4 Vizitat në prona do të bëhen gjithmonë të shoqëruara nga agjensia.
- 3.5 Klienti do t’i paguajë agjensisë shumën përkatëse sikurse parashikohet në këtë marrëveshje.
- 3.6 Për më tepër, unë, i nënshkruari, shprehimisht bie dakord dhe autorizoj Kontrolluesin që të mbledhë, ruajë, përdorë, përpunojë, përhapë dhe transferojë të Dhënat Personale tek autoritetet publike, gjyqësore dhe/ose agjensitë e zbatimit të ligjit sic kërkohet nga legjislacioni në fuqi. Unë ruaj të drejtën që t’i kërkoj Kontrolluesit të më japë informacion nëse të Dhënat e mia Personale po përpunohen. Unë, i nënshkruari e jap pëlqimin lirisht, në dijeni të plotë dhe me vullnetin tim të lire.

#### **Neni IV**

### **PAGESA DHE KUSHTET E PAGESËS**

4.1 Për ofrimin e shërbimeve të ndërmjetësimit, klienti do t'i paguajë agjensisë një tarifë shërbimi 1/2 (gjysëm) e çmimit të qirasë mujore për kontrata qiraje nga 0-3 vite dhe tarifen e shërbimit 1(një) qira mujore për kontrata mbi 3 vite. Klienti do të paguajë çmimin me transfertë bankare në llogarinë bankare të përcaktuar nga agjensia ose në një formë tjetër të rënë dakort nga palët.

4.2 PAGESA duhet të kryhet në ditën kur është parashikuar pagesa efektive për qiradhenien e pronës.

4.3 Në rastin kur klienti merr pronën e cila i është ofruar fillimisht nga agjensia, nëpërmjet refuzimit, negocimit të drejtpërdrejtë me qiradhënësin ose në çdo mënyrë tjetër e cila synon të shmangë agjensinë, klienti detyrohet t'i paguajë agjensisë vlerën përkatëse për të cilën ishte rënë dakord më parë si dhe një shumë prej 25 % (përqind) të çmimit që detyrohet.

4.4 Në rast se klienti nuk transferon çmimin në kohën e duhur, do t'i paguajë agjensisë një dëmshpërblim prej 0,2 % (përqind) të shumës së rënë dakord në paragrafin 4.1, për çdo ditë vonesë.

#### **Neni V**

### **AFATI DHE PËRFUNDIMI I KONTRATËS**

5.1 Afati i kësaj marrëveshje është ( ) muaj dhe hyn në fuqi me nënshkrimin e palëve.

5.2 Kjo marrëveshje mund të zgjidhet nga klienti me njoftim paraprak të agjensisë të paktën 15 ditë nga anullimi i kërkesës.

5.3 Klienti nuk ka të drejtë të zgjidhë këtë marrëveshje nëse kanë filluar negociatat me një qiradhënës të mundshëm, negociata këto që vërtetohen në menyrë shkresore (si kontratë kapari, kontratë rezervimi, kapar negociimi etj). Në rast se klienti zgjidh kontratën ndërkohë që kanë filluar negociatat, do t'i paguajë agjensisë çmimin e përcaktuar në paragrafin 4.1 më sipër si dhe një shumë prej 25% të çmimit që i detyrohet.

#### **Neni VI**

### **LIGJI I ZBATUESHËM**

6.1 Kjo marrëveshje është përpiluar dhe do të interpretohet sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.

6.2 Të gjitha mosmarrëveshjet ndërmjet palëve do të zgjidhen me negociime dhe në mënyrë miqësore ndërmjet tyre.

6.3 Në rast se palët nuk arrijnë një marrëveshje brenda 30 (tridhjetë) ditësh, nga data e lindjes së mosmarrëveshjes, mosmarrëveshja do të zgjidhet nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

6.4 Kjo marrëveshje është përpiluar në gjuhën shqipe, në dy kopje origjinale nga një kopje për secilën palë.

AGJENSIA

KLIENTI

---

---